



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



Qendra për Punë Sociale

PLANI I PUNES SË QENDRËS PËR PUNË SOCIALE PËR VITIN 2025

Veprimtaria e QPS-së përfshinë ofrimin e përkujdesjes dhe mirëqenies sociale për banorët e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqërorë, përmes ofrimit dhe zbatimit të konceptit të punës sociale dhe mirëqenies sociale në kuadër të sistemit unik të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale në Kosovë.

Koncepti i përkujdesjes social konsiston në atë që banorëve të komunës t'iu ofrojë dhe zbatojë përkujdes dhe mirëqenie sociale, këshillime gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shoqërore: Psikologji, Punë Sociale, sociologji, Juridik, pedagogji, përmes caktimit të ekspertëve profesional të cilët për rastet në nevojë sociale do të jenë të domosdoshëm në sistemin e përkujdesjes social dhe të mirëqenies sociale dhe njëherësh pikë referuese për specialistët konsultant në përkujdesjen dhe mirëqenien sociale.

Përkujdesja dhe mirëqenia sociale në QPS-së sigurohet dhe zbatohet nga zyrtarët e shërbimeve sociale dhe të skemës sociale të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Kosovë.

Qëllimi i Planit të punës: Plani i punës do të paraqes objektivat dhe aktivitetet e planifikuara për shërbime sociale edhe familjare për vitin 2025, i cili do të ketë prioritetizimin e shërbimeve sociale dhe familjare me fokus kategoritë dhe grup moshat më të cenueshme që duhet të përfitojnë shërbime profesionale.

Nr.	Objektivat/detyra e punës	Aktivitetet
1.	<p>-Zbatimi i Ligjit të SAS-it nr.2003/15 si dhe ndryshimit dhe plotësimit e këtij ligji nr.04/L096</p>	<p>1.1 Monitorimi i zbatimit të Ligjit si dhe të udhëzimeve administrative që kanë të bëjnë me SAS-it;</p> <p>1.2 Pranimi i kërkesave për asistencë sociale;</p> <p>1.3 Vlerësimi i gjendjes socio-ekonomike të familjes(vizita ne terren);</p> <p>1.4 Vlerësimi i rasteve ne Komisionin mjekësor;</p> <p>1.5 Futja e lendeve ne bazën e te dhënave për pagese;</p> <p>1.6 Njoftimi i palëve për vendimin e marrë;</p> <p>1.7 Shqyrtimi i ankesave të palëve</p> <p>1.8 Dërgimi i ankesave ne shkallen e dyte ne DPSF-DNS;</p> <p>1.9 Identifikimi dhe përpilimi i listës se familje në nevojë;</p> <p>1.10 Distribuimi i pakove;</p> <p>1.11 Tërheqja e artikujve nga përfituesit (listat me nënshkrime te përfituesve)</p>
2.	<p>- Zbatimi i legjislacionit të aplikueshme për shërbimet sociale dhe familjare, si dhe doracakëve dhe standardeve të aprovuara për mbrojtjen e fëmijëve e kategorive tjera sociale.</p> <p>Ligji Nr. 08/L-255 Për Shërbime Sociale dhe familjare, Ligji nr. 06/L-084 Për mbrojtjen e fëmijës, Ligji Nr. 2004/32</p>	<p>2.1 Monitorimi dhe zbatimi i ligjeve të shërbimeve sociale dhe familjare;</p> <p>2.2 Monitorimi dhe zbatimi i ligjit për mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>2.3 Monitorimi dhe zbatimi i ligjit të familjes në Kosovë;</p>

	<p>Për Familjen i Kosovës, Kodi për te mitur ne Kosove, ligji Nr. 03/L-182 Për mbrojtje nga dhuna ne Familje, Strategjinë Kombëtare për mbrojtje nga dhuna ne familje dhe dhuna ne baza gjinore, ligji nr. 06/L-114 Për zyrtarët publik, e shume Rregullore dhe Udhëzime Administrative.</p>	<p>2.4 Monitorimi dhe zbatimi i kodit penal për të mitur;</p> <p>2.5 Monitorimi dhe zbatimi i ligjit kundër dhunës në familje;</p> <p>2.6 Monitorimi se sa po aplikohen standardet me rastin e ofrimit të shërbimeve sociale, të aprovuara nga ana e MPMS (tani MFPT);</p> <p>2.7 Monitorimi dhe zbatimi i ligjit te zyrtareve publik.</p>
<p>3.</p>	<p>- Strehimi familjar i fëmijëve pa përkujdesje prindore, fëmijëve të braktisur,</p>	<p>3.1 Caktimi i Menaxherit të rastit;</p> <p>3.2 Identifikimi i prindërve biologjik;</p> <p>3.3 Caktimi i kujdestarit ligjor;</p> <p>3.4 Caktimi i emrit të fëmijës;</p> <p>3.5 Promovimi i strehimit familjarë;</p> <p>3.6 Vizitat ne familje së paku një herë në muaj ;</p> <p>3.7 Përzgjedhja e familjeve strehuese(vlerësimi);</p> <p>3.8 Përkrahja dhe stimulimi i familjeve strehuese;</p> <p>3.9 Përpilimi e vendimit dhe kontratës për strehim.</p> <p>3.10 Monitorimi i familjeve strehuese;</p> <p>3.11. Rikthimi ne familjen adoptuese;</p> <p>3.12. zgjidhja e statusit ligjor;</p>

		<p>3.13 Periudha provuese e Adoptimit;</p> <p>3.14 Adoptimi</p>
4.	- Strehimi i fëmijëve tek të afërmit	<p>4.1 Caktimi i Menaxherit të rastit;</p> <p>4.2 Plani i veprimit;</p> <p>4.3 Caktimi i Kujdestarit ligjor;</p> <p>4.4 Vlerësimi i përshtatmëris së familjes dhe kujdestarit ligjor të fëmijës;</p> <p>4.5 Përpilimi i vendimit dhe kontratës për strehim;</p> <p>4.6 Vendosja ne pagese</p> <p>4.7 Vizitat në familje së paku një herë në muaj;</p>
5.	- Strehimi rezidencial i fëmijëve pa përkujdesje familjare	<p>5.1 Caktimi i Menaxherit të rastit;</p> <p>5.2 Vendosja emergjente e fëmijës në strehimore;</p> <p>5.3 Caktimi i Kujdestarit ligjor;</p> <p>5.4 Inicimi i procedurës në gjykatë për marrjen e të drejtës prindërore;</p> <p>5.5 Nënshkrimi i kontratës për strehim në mes QPS-së dhe Strehimores;</p> <p>5.6 Vizitat në strehimore së paku një herë në muaj;</p> <p>5.7 Rikthimi i fëmijës ne familjen biologjike</p>
6.	- Fëmijët me Aftësi të Kufizuar	<p>6.1 Pranimi i kërkesave për ndihmë materiale;</p> <p>6.2 Caktimi i menaxherit të rastit;</p>

		<p>6.3 Përgatitja e lëndës për vlerësim në KM;</p> <p>6.3 Vizitat në familje së paku dy herë në vit;</p> <p>6.4 Referimi i rasteve për trajtim në OJQ-ët e ndryshme që ofrojnë shërbime sociale për këtë kategori</p> <p>6.5 Vazhdimi i projektit me Handi-Kos: Handi Fer, Pema, Down Syndrom etj.</p> <p>6.6 Identifikimi i personave me aftësi të kufizuar në komunën e Ferizajt.</p>
7.	- Mbrojtja e fëmijëve nga punët e rënda	<p>7.1 Identifikimi i fëmijëve që merren me punë të rënda;</p> <p>7.2 Caktimi i menaxherit të rastit;</p> <p>7.3 Vlerësimi i gjendjes socio-ekonomike e familjes;</p> <p>7.4 Këshillime psiko-sociale, shkollim, aftësim profesional, sensibilizim;</p>
8.	- Mbrojtja e fëmijëve me sjellje asociale	<p>7.5 Ofrim të një ndihme sociale për familjen, në rast të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara me ligj.</p> <p>8.1 Identifikimi i fëmijëve me sjellje asociale;</p> <p>8.2 Caktimi i menaxherit të rastit;</p> <p>8.3 Risocializimi;</p> <p>8.4 Vendosja në strehim familjar tek të afërmit;</p> <p>8.5 Këshillime psiko-sociale, shkollim, aftësim;</p> <p>8.6 Kujdestaria</p>

9.	- Strehimi rezidencial për persona të moshuar pa përkujdesje familjare	<p>9.1 Përgatitja e dokumentacionit;</p> <p>9.2 Vizita ne teren dhe vlerësimi;</p> <p>9.3 Referimi në shëndetësi;</p> <p>9.4 Dërgimi i lëndës ne D.P.S.F, për dhënia n e pëlqimit për strehim;</p> <p>9.5 Vendosja e klientit në Shtëpinë e pleqve</p>
10.	- Mbrojta e Viktimave të Dhunës në Familje , Femijeve te Keqtrajuar, te Dhunuar seksualisht.	<p>10.1 Evidentimi i rastit;</p> <p>10.2 Caktimi i menaxherit të rastit;</p> <p>10.3 Vlerësimi i rastit</p> <p>10.4 Bashkëpunimi me policin, mbrojtësen e viktimave, Prokurorinë, Gjyqësorin, Qendrën e aftësimin profesional, organizata te ndryshme shkollat, Drejtorite komunale etj.</p> <p>10.5 Caktimi i Kujdestarit ligjor;</p> <p>10.6 Strehimi i viktimave ne strehimore, ne familjet strehuese etj.</p> <p>10.7 Raportim ne bazën e te dhënave,</p> <p>10.8 Përcjellja e rasteve për re-integrim ne familje.</p>
11.	- Qiftet bashkëshortore në proces të shkurorëzimit nga martesat me kurorë	<p>11.1 Caktimi i menaxherit të rastit</p> <p>11.2 Vlerësimi i rastit</p> <p>11.3 Marrja e deklaratave.</p> <p>11.4 Sanimi i marrdhenjeve bashkshortore</p> <p>11.5 Dhënia e mendimit dhe propozimit për institucionet tjera(Gjykatat, Shkollën, Çerdhet etj)</p> <p>11.6 Propozimi për besimi i fëmijëve</p>

		11.7 Organizimi i kontakteve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore.
12	Bashkëpunimi me Komuen, MD dhe MFPT (DPSF),organizatat qeveritare jo qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare.	12.1 Koordinim dhe bashkëpunim i ngushtë në nivel Komunal dhe Qendror me qëllim të avancimit të shërbimeve më të mira për qytetarët; 12.2 Raportimi mujor, periodik për Kabinetin e kryetarit dhe DPSF; 12.3 Iniciativa dhe takime me donatorët e ndryshëm me qëllim të ofrimit të ndihmave shtesë për raste sociale, ku do të ndikojmë në uljen e varfërisë së skajshme; 12.4 Referim i rasteve tek të gjitha OJQ-ët të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme sociale, si dhe në të njëjtën kohë pranim i rasteve të cilat neve na referohen.
13.	Ofrim i shërbimeve në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.	13.1 Zbatimi i përpiktë i etikës së zyrtarëve siç e parasheh Ligji për zyrtaret publik; 13.2 Zbatimi i etikës profesionale të zyrtarëve që ofrojnë shërbime sociale si dhe mos diskriminimi në baza gjinore, komunitare, racore, fetare etj;
14.	Menaxhimi i punëve dhe detyrave të punës për të gjithë stafin	14.1 Takimet e përjavshme me sektorët në QPS-së,për të shqyrtuar punët dhe vështirsit që dalin nga puna; 14.2 Angazhim për ngritjen profesionale të stafit të Qendrës me qëllim të avancimit të shërbimeve që u ofrohen rasteve në nevojë;

15.	Bashkëpunim i ngushtë me Policinë e Kosovës	<p>15.1 Në asistim të Policisë së Kosovës do të kemi aksione të përbashkëta me qëllim të zvogëlimit të dukurisë së punëve të rënda të fëmijëve ,kërkim lëmshës si dhe dukurive të tjera negative të përhapura në komunën tonë;</p> <p>15.2 Përfaqësim nga ana e zyrtarëve të shërbimeve sociale në cilësinë e Organit të Kujdestarisë në polici në rastet e inetervistimit të fëmijëve.</p>
16.	Bashkëpunimi me mjetet e informimit	<p>16.1 Organizim i tryezave, ku do të debatohet për rolin e Organit të kujdestarisë në kuadër të QPS-së si dhe për dukurit tjera negative në shoqërinë tonë;</p> <p>16.2 Do të bëjmë sensibilizimin e qytetarëve për projektin “Strehimi familjar” për fëmijët e braktisur si dhe ata të strehuar tek të afërmit e tyre, në kuadër të kësaj po ashtu do të organizojmë takime me prindërit në shkolla si në qytet po ashtu edhe në fshatra; “Fushata senzibilizuese per dhunen ne familje, dhunen me baze gjonore” etj.,</p> <p>16.3 Do jemi transparent me të gjitha mjetet e informimit, për të gjitha shërbimet të cilat i ofron QPS-së.</p>
17.	<p>1. Përcjellja financiare e buxhetit të QPS-së</p> <p>2. Inventari dhe logjistika.</p>	<p>17.1 Shfrytëzimi racional i mjeteve në bazë të alokimeve të lejuara nga BKK;</p> <p>17.2 Mbrojtja e inventarit dhe logjistikës së QPS-së</p>

18.	Kod emergjent për shërbime sociale	18.1 Të miturit ne konflikt me ligjin 18.2 Fëmijët me sjellje asociale 18.3 Fëmijët te cilët punojnë ne rruge 18.4 Pagesa te kurseve te ndryshme 18.5 Pagesa për rastet emergjente për strehim 18.6 Personat pa përkrahje familjare; 18.7 Fëmijët e keqtrajtuar, 18.8 Gratë dhe fëmijët viktima të dhunës në Familje dhe dhunes seksuale, 18.9 Kategori te tjera ne nevojë për shërbime sociale
-----	------------------------------------	---

Për realizimin në përpikëri të këtij Plani nga ana e zyrtarëve të Qendrës për Punë Sociale, Kabinetit të Kyetarit në Komunen e Ferizajt i propozojmë këto kërkesa:

- Zyrtarëve të shërbimeve sociale, duhet të ju paguhet puna e kujdestarisë sipas nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë, si dhe nenin 11 paragrafi 1, 2, 3 dhe 6 të Rregullores nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të nëpunësve civilë,
- Sigurimi i së paku dy automjeteve dhe shoferëve, që do të ndikonte shumë në identifikimin dhe vlerësimin sa ma të shpejt të nevojave të klientëve;
- Një gjenerator për nevojat e Qendrës për Pune Sociale ne raste te mungesës se energjisë elektrike.
- Blerja e Kompjuterëve për disa zyrtarë, për shkak se kompjuterët aktuale janë vjetërsuar;
- Blerja e dy Printerëve;
- Blerja e inventarit ne zyrën e Drejtorit dhe zyrat e tjera,
- Trajnimet për zyrtaret e Shërbimeve Sociale, Asistencës Sociale dhe zyrtares financiare, ne baze te standardeve;

- Ndarjen e subvencioneve për: Strehimoren për viktimat e dhunës në familje “Shtëpia ime”, për OJQ-ët që merren me Fëmijët e Keqtrajtuar, ”Pema”, “Handikos”, “Hendifer” “Down Syndrom” të cilat merren me trajtimin e fëmijëve me AK,
- Ndertimi i objektit të QPS-se, sepse hapsira e tanishme nuk i plotson fare kushtet për ofrim të shërbimeve sociale dhe konfidenciale. Objekti i QPS-se ndodhet në katin e parë dhe nuk ka ashensor, që është problematik e madhe që të ofrojmë shërbime sociale për personat me aftësi të kufizuara,
- Ndërtimi i shtëpise për mbrojtjen e fëmijëve
- Ndërtimi i strehimores për të Moshuarve pa përkujdesje familjare,
- Stimulimi i familjeve strehuese në vlerë prej 100 € në muaj dhe pagesa e medikamenteve për fëmijët e braktisur të vendosur në familjet strehuese dhe pagesa e barerave,
- Rritja e stafit, plotësimi i 5 pozitave aktuale, pozita e Udhëheqësit të Shërbimeve Sociale, Pozita e udhëheqësit të Asistencës Sociale, pozita e Zyrtareve të Shërbimeve Sociale,
- Po ashtu të shtohet stafi me një Psikolog klinik dhe një jurist sepse në QPS nuk kemi asnjë jurist dhe që nevojën për këta profesionistë është shumë e madhe edhe për faktin se në kuadër të QPS funksionon Organi i kujdestaris ku sipas ligjit, është organ i përbërë nga një grup profesionistësh Psikolog, Jurist, Pedagog, Puntor Social dhe Sociolog, me profilet aktuale që i kemi në QPS(Puntor social dhe Sociolog) nuk mund ta themelojmë organin e kujdestarise dhe në mungesë të profesionistëve nuk mund ta kryejmë rolin e Organit të kujdestarise.
- Të miratohet Kodi Buxhetor për raste Emergjente,
- Rritja e buxhetit për Qendrën për Punë Sociale për 20% të shumës aktuale,
- Përkrahja e rasteve në nevojë emergjente me artikuj ushqimorë dhe higjienik.

Ferizaj 22.01.2025

**Drejtoresha e QPS Ferizaj
Adelina Rexhepi Braha**